



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA VLORË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME RREGULLATORE
DREJTORIA E BASHKËQEVERISJES

Nr. 18132 prot.

Vlorë, më 08.09.2026

PROCESVERBAL KONSULTIMI PUBLIK

NJËSIA ADMINISTRATIVE ORIKUM

DATË 24.08.2026 ORA 10:00

Tema: Konsultimi i Buxhetit Afatmesëm 2027-2029 dhe planifikimi për projekt buxhetin e vitit 2027 për Bashkinë Vlorë.

Baza ligjore: Në zbatim të ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” neni 18; ligjit nr.119/2014 “Për të drejtën e informimit”, ligjit nr.146/2014 “Për njoftimin dhe konsultimin publik” pika 1 dhe 2 neni 5, pika 1,2,3 neni 52; Rregullores e Organizimit dhe Funksionimit të Bashkisë; si dhe Kalendarit të Konsultimit Publik nr.16533 prot, datë 13.08.2026

Marrin pjesë:

Kryetare e Bashkisë – znj. Brunilda Mersini, Kryetari i N.J.A.Orikum, z.Drini Harizaj, Sekretare e Këshillit Bashkiak – znj.Launela Dautaj, Drejtor i Financës - z. Hiqmet Haxhaj, drejtorë të Administratës së Bashkisë Vlorë, përfaqësues nga komuniteti, përfaqësues nga biznesi.

(Në takim morrën pjesë 30 persona.)

Takimin e hap Kryetare e Bashkisë Vlorë, znj. Brunilda Mersini: Ju falenderoj të gjithëve që i jeni përgjigjur kërkesës sonë për të marrë pjesë në dëgjesat publike për Buxhetin e Bashkisë për vitin 2027. Qëllimi ynë është që projektet dhe investimet të përcaktohen duke u bazuar në nevojat dhe kërkesat konkrete të komunitetit. Sot kemi ardhur për t’ju dëgjuar dhe për të marrë nga ju kërkesat, problematikat dhe propozimet që mendoni se duhet të përfshihen në prioritetet e buxhetit të vitit 2027.

Që prej datës 1 dhjetor, kur kam filluar punën, kemi vijuar me përcaktimin e prioritetëve, duke marrë në konsideratë edhe situatën infrastrukturore në qytet. Një pjesë e konsiderueshme e

infrastrukturës është dëmtuar si pasojë e investimeve të rëndësishme në rrjetin e ujësjellësit, të cilat kanë qenë të domosdoshme për përmirësimin e shërbimeve për qytetarët. Edhe zona e Orikut ka pasur vëmendjen e saj për sa i përket investimeve, ku mund të përmendim edhe ndërhyrjet në rrugën “Jul Çezari”. Megjithatë, me Buxhetin e vitit 2027 synojmë që zona juaj të ketë edhe më shumë vëmendje dhe të përfshihet në mënyrë më të gjerë në planifikimin e investimeve. Kemi një projekt për Ujësjellësin e Tragjasit, i cili është vendosur me prioritet, bazuar në kërkesën e Bashkisë, së bashku me projektin për lulishten e Tragjasit. Gjithashtu, janë vendosur si prioritet dhe kërkesat për shkollën dhe rrugën e Dukatit. Tani, po ju dëgjoj juve për të vijuar me propozimet dhe vlerësimet tuaja.



Banor: Të falenderojmë dhe të vazhdojmë kështu me punën. Ekziston nevoja për ndërhyrje në rrugët e brendshme, veçanërisht në rrugën e varrezave.

Kryetare e Bashkisë Vlorë, znj. Brunilda Mersini: Pa përfunduar punimet e ujësjellësit, nuk mund të ndërhyjmë dot në rrugë.

Banor: Bulevardi i ka dhënë shumë pamje dhe një paraqitje më të bukur qytetit. Do të ishte mirë të bëhej një ndërhyrje në rrugën para, në drejtim të daljes së qytetit, konkretisht në rrugën “Demokracia”. Gjithashtu, ka nevojë për një qendër shëndetësore. Sugjerohet që godina e ish-shkollës së mesme të bashkohet me shkollën ekzistuese.

Kryetare e Bashkisë Vlorë, znj. Brunilda Mersini: Nuk mund të bëjmë ndërhyrje pa përfunduar më parë regjistrimin juridik të pronave. Shkollat dhe kopshtet do t'i rikthejmë në investime të Bashkisë.

Banor: Në qendër të vëmendjes duhet të jetë edhe sporti, i cili ka nevojë për mbështetjen tuaj.”

Kryetare e Bashkisë Vlorë, znj. Brunilda Mersini: Sportit i kemi dhënë vëmendje, gjithmonë në përputhje me mundësitë dhe buxhetin e Bashkisë. Po ashtu, edhe aktivitetet kulturore në qytet janë shumë të rëndësishme dhe kanë kontribuar në mbajtjen gjallë të jetës së qytetit, ku një rol të rëndësishëm kanë pasur edhe fondacionet. Ndërsa, si Bashki, prioritet i kemi dhënë kopshteve dhe shkollave, duke vënë në fokus interesin dhe mirëqenien e fëmijëve.

Banor, Jurjet Vangjeli: Problem me Hidrovorin. Dua të bëj një investim në tokën time, por ajo përmytet dhe është e pamundur.

Rruga “Çerçiz Topulli” ka nevojë për ndërhyrje. Duhet investim në fushën e Dukatit

Banor: Heqja e statusit të bashkisë na heq prioritetet. Kemi probleme me kanalizimet dhe vuajmë mungesën e ujit. Punohet me ujin e kënetës. Bashkia duhet ta kthejë vëmendjen te Orikumi dhe te bizneset, pasi ne i paguajmë të gjitha taksat.

Kryetare e Bashkisë Vlorë, znj. Brunilda Mersini: Ujësjiellës-kanalizimet nuk janë në varësi të Bashkisë, ndaj nuk mund të bëj premtime. Këtë shqetësim do ta përcjell në Agjencinë Kombëtare të Ujësjiellës-Kanalizimeve.

Banor: Faleminderit për pastrimin e qytetit, i cili po bëhet sistematikisht. Problemi është rruga që të çon te plazhi, e cila është në gjendje emergjente. Gjithashtu, kanalet duhet të sistemohen, pasi ka erë të pakëndshme nga ujërat e zeza.

Banor: Nevojë për një park për fëmijët dhe të moshuarit. Gjithashtu, ka nevojë për transport publik.

Banor: Problem me hedhjen e mbeturinave. Ka nevojë për vendosjen e koshave familjarë.

Kryetare e Bashkisë Vlorë, znj. Brunilda Mersini: Problem janë bizneset të cilat nuk zbatojnë oraret e përcaktuara dhe, për këtë arsye, marrin gjoba.

Banor: Faleminderit për interesin që keni treguar për Orikumin. Uroj që prezenca fizike të përputhet edhe me prezencën financiare, duke investuar në zonë. Dukati, si fshat, ka nevojë për ujë dhe kanalizime, ndërsa zona bregdetare ka nevojë për investime. Problematika ka edhe me ujin, dritat dhe rrugët. Të gjithë paguajmë taksat dhe nuk marrim shërbimin që na takon. Kërkoj vendosjen e një kabine elektrike në lagjen ku banoj dhe për këtë kërkoj bashkëpunimin

Kryetare e Bashkisë Vlorë, znj. Brunilda Mersini: Këtë kërkesë do ta përcjell te institucionet përgjegjëse për shqyrtim dhe jo ta zgjidh.

Banor: Problematika kryesore është gjendja e rrugës, e cila ka nevojë për ndërhyrje.

Kryetare e Bashkisë Vlorë, znj. Brunilda Mersini: Janë bërë investime të rëndësishme, si Bulevardi i Orikumit, por zona ka nevojë edhe për ndërhyrje në rrugët e brendshme. Si prioritete kemi Qendrën Shëndetësore, e cila ka vlerë të madhe për zonën, rregullimin e rrugëve me më shumë kalueshmëri, si dhe përmirësimin e kopshteve dhe parkut të lojërave.

Banor i fshatit Tragjas: Jam bujk dhe kërkoj pastrimin e kanaleve, si dhe rregullimin e rrugës.

Banor i fshatit Dukat: Rruga “Ali Cani” ka nevojë për një çezmë. Gjithashtu, nevojitet rehabilitimi i varrezave të fshatit, furnizimi me ujë dhe ndriçimi i zonës.

Banor: Në qendër të Orikumit, shtëpitë me eternit kanë nevojë për ndërhyrje. Në hyrje të qytetit ka nevojë për vendosjen e një table orientuese dhe për ndriçim. Qendra shëndetësore duhet të spostohet ose të ndërhahet për përmirësimin e saj.

Banor: Punonjësit janë të nënpaguar.

Kryetare e Bashkisë Vlorë, znj. Brunilda Mersini: Një punëtor pastrimi aktualisht merr 75.000 Lekë.

Banor: Rruga “Donika Kastrioti”, si dhe rrugët e brendshme të Orikumit, kanë nevojë për ndërhyrje. Gjithashtu, nevojitet ndërhyrje në rrugën që të çon te Kisha e Marmiroit.

Banor: Në Dukat mungon uji dhe ndriçimi.

Kryetare e Bashkisë Vlorë, znj. Brunilda Mersini: Kemi blerë pajisjet e nevojshme për ndriçimin e gjithë zonës.

Banor: Problem janë stacionet elektrike deri në Tragjas, si dhe ujërat e zeza.

Kryetare e Bashkisë Vlorë, znj. Brunilda Mersini: Do ta përcjell këtë shqetësim te Ujësjellësi dhe te OSHEE. Prioritet do t’u jepet zonave më të banuara. Faleminderit!

Konceptoi:
Aurora Kamberaj
Koordinatorë për Njohim dhe Konsultim Publik